

V E N D I M
Nr.82 datë 26.2.1993

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE NË SEKTORIN E PYJEVE

Me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Pyjeve, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Tarifat e shitjes së lëndës së drurit në këmbë për parcelat, pjesët ekonomike ose ekonomitë pyjore ku ka rrugë automobilistike, të jenë sipas pasqyrës nr.1 që i bashkëngjitet këtij vendimi. Për llojet ah, lis, pishë e bredh këto tarifa i përkasin bonitetit të tretë të pyllit.

2. Për bonitetin e parë dhe të dytë të llojeve ah, lis, pishë e bredh vlefëta e tarifës rritet me 30 për qind kundrejt vlefës së tarifës së bonitetit të tretë, kurse për bonitetin e katërt e të pestë vlefëta e tarifës ulët me 10 për qind kundrejt asaj të bonitetit të tretë. Për llojet e tjera drusore tarifat janë të pandryshueshme.

3. Për parcelat, pjesët ekonomike ose ekonomitë pyjore, ku mungojnë rrugët automobilistike, për investimet që do të kryhen për shfrytëzimin e tyre nga ndërmarrjet shtetërore me mjetet financiare nga burimet e tyre të brendshme, nga personat fizikë vendas a të huaj, sipas raportit lekë-investime që do të kryhen për 1 m³ lëndë punimi në këmbë, do të bëhet korrektimi i tarifave bazë për çdo bonitet si më poshtë:

- Për raportin deri 100 lekë investime për 1 m³ lëndë me koeficientin 0.9.
- Për raportin 101-200 lekë investime për 1 m³ lëndë me koeficientin 0.8.
- Për raportin mbi 201 lekë investime 1 m³ lëndë me koeficientin 0.7.

Këto tarifa janë të njëjta edhe me shoqëritë e përbashkëta, personat fizikë ose juridikë të huaj.

4. Shitja e lëndës në këmbë do të bëhet me ankand, duke pasur si pikënisje tarifat e përcaktuara në pasqyrën nr.1 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

5. Tarifat për shpyllëzimet e miratuara në fondin pyjor janë sipas pasqyrës nr.3 i bashkëngjitet këtij vendimi.

6. Tarifat për përdorimin e pyjeve ose pjesëve të pyjeve për qëllime pushimi, shëndetësore e turizmi janë sipas pasqyrës nr. që i bashkëngjitet këtij vendimi.

7. Tarifat për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara në fondin pyjor janë sipas pasqyrës nr.5 që i bashkëngjitet këtij vendimi.

8. Çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi